

ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Nëntor 2024

DREJTORI I DOGANAVE GENTI GAZHELI NË TAKIMIN E NIVELIT TË LARTË TË DREJTUESVE TË DOGANAVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR ME VENDET E BE-së NË BUDAPEST



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave z. Genti Gazheli mori pjesë në Takimin e Nivelit të Lartë të Drejtorëve të Doganave të Ballkanit Perëndimor me vendet e BE-së në Budapest, Hungari. Gjatë fjalës së mbajtur në këtë takim ai u shpreh se procesi i integritit evropian dhe konvergjenca drejt Unionit Doganor po bëhen gjithmonë e më të prekshme për Shqipërinë falë edhe presidencës hungareze që i ka shtyrë gjërat shumë fort përpara.

Nga ana tjetër drejtori i Doganave theksoi se në funksion të tregtisë së lirë, nëpërmjet marrëveshjes CEFTA është rritur bashkëpunimi mes Administratave Doganore të vendeve të rajonit, sidomos në fushat e shkëmbimit të informacionit, lehtësimit të tregtisë dhe luftën kundër trafikëve.

Pjesëmarrësit në këtë takim diskutuan mbi ndarjen e praktikave më të mira të bashkëpunimit rajonal, si dhe vlerësimin e përgatitjes së procesit të integritit në BE të Ballkanit Perëndimor. Në përfundim të takimit, Dogana Shqiptare mori angazhimin për organizimin e takimit të radhës të këtij niveli, vitin e ardhshëm në Tiranë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE GENTI GAZHELI NË SAMITIN BOTËTOR PËR KLIMËN, COP 29 NË AZERBAJXHAN

Më 20 nëntor, në kuadër të Konferencës së 29 të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (COP29), u mbajt në Baku, Azerbajxhan konferenca me temë "Doganat e Gjelbra: Dialogu mes Drejtuesve të Doganave".

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave z. Genti Gazheli së bashku me drejtues të doganave nga vende të ndryshme të botës dhe përfaqësues të Organizatës Botërore të Doganave morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga Komiteti Shtetëror i Doganave të Republikës së Azerbajxhanit ku për herë të parë u diskutuan çështjet doganore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.



Duke diskutuar për rëndësinë e ngjarjes kushtuar nismës "Dogana e Gjelbër" në këtë konferencë u theksua roli strategjik i shërbimeve doganore në mbrojtjen e mjedisit dhe rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë drejtim. Ky aktivitet shënoi një hap të rëndësishëm si në zgjidhjen e problemeve globale mjedisore, ashtu edhe në rritjen e rolit të autoriteteve doganore në luftën kundër ndryshimeve klimatike.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE, GENTI GAZHELI VIZITË ZYRTARE NË DOGANËN E KOSOVËS

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Shqipërisë, Z. Genti Gazheli, së bashku me një delegacion të përbërë nga drejtues të drejtorive kryesore të Administratës Doganore Shqiptare, zhvilloi një vizitë zyrtare në Doganën e Kosovës, ku u prit nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Z. Agron Llugaliu dhe ekipi i tij.

Vizita u përqendrua në forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet dy institucioneve, si dhe përpjekjet e përbashkëta për lehtësimin e tregtisë mes dy vendeve.

Një pikë e rëndësishme e diskutimeve ishte procesi i integritit evropian, duke pasur parasysh fillimin e negociatave të Shqipërisë për anëtarësim në BE. Ekipi shqiptar ndau informacione të vlefshme me Doganën e Kosovës, të cilat priten të ndihmojnë në përgatitjet e mëtejshme drejt përmbushjes së standardeve europiane.



20 SPECIALISTË TË RINJ TË DOGANAVE SHQIPTARE, TRAJNIM NË AKADEMINË E GUARDIA DI FINANZA-S

20 specialistë të rinj të Administratës Doganore Shqiptare zhvilluan një trajnim mbi Veprimtarinë e kontrollit dhe luftës së trafikut të paligjshëm në fushën doganore", në Akademinë e Guardia di Finanza-s, në Ostia, Itali.

Në ceremoninë e zhvilluar në nisje të këtij trajnimi ishin të pranishëm komandanti i Akademisë së Guardia di Finanza, gjeneral Francesco Mattana, shefi i Departamentit të Komandës së Përgjithshme të Guardia di Finanza, Gjeneral Vito Giordano, si dhe Drejtori i Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Agjencisë Italiane të Doganave e Monopoleve, Andrea Mazzella, i cili përcolli urimet më të mira për grupin e të rinjve të Doganës Shqiptare.

Trajnimi është pjesë e Memorandumit të Bashkëpunimit mes Administratës Doganore Shqiptare, Agjencisë Italiane të Doganave e Monopoleve dhe Guardia di Finanza, i cili u nënshkrua në muajin Prill të këtij viti në Tiranë.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE VIJON PLANIN OPERACIONAL PËR KONTROLLIN E HIDROKARBUREVE

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave ka vijuar Planin Operacional për kontrollin e hidrokarbureve.

Ky plan ka për qëllim monitorimin e të gjithë zinxhirit furnizues të karburanteve nga importi, depozitimi në magazinat doganore, shitja me shumicë, e deri tek furnizimi i pikave të shitjes me pakicë.

Për zbatimin e këtij plani janë organizuar grupe kontrolli me shërbim 24/7 në çdo degë doganore si në hyrje ashtu edhe në dalje për të siguruar mbarëvajtjen e procesit.



DOGANA SHQIPTARE PJSË E TAKIMEVE NË KUADËR TË PROJEKTIT MBËSHTETJE PËR INTEGRIMIN EKONOMIK RAJONAL ZBATUAR NGA GIZ

Në kuadër të projektit Mbështetje për Integrimin Ekonomik Rajonal, i zbatuar nga GIZ me mbështetjen e qeverisë gjermane dhe BE, u mbajtën në Tiranë një seri takimesh me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganës Shqiptare.

Me qëllim përmirësimit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Riskut në datën 25 Nëntor u zhvillua një takim me ekspertët ndërkombëtarë ku u ndanë zhvillimet më të fundit. Përgjatë takimit u përgëzuan zhvillimet e arritura nga Administrata Doganore jo vetëm si institucion përgjegjës për të mbledhur të ardhurat, por vecanërisht përpjekjet për zbatimin e ligjit.



Nga ana tjetër u vlerësua roli dhe mbështetja e Administratës Doganore Shqiptare në integrimin ekonomik rajonal. Gjithashtu, në fokus të këtij takimi rajonal ishte bashkëpunimi midis agjencive kufitare me qëllim për të lehtësuar në një front të përbashkët tregtinë ndër-rajonale.

DOGANA SHQIPTARE KRYESON TAKIMIN E 21-të TË TASK FORCËS KUNDËR MASHTRIMIT DHE KONTRABANDËS TË SELEC NË BUKURESHT



Dogana Shqiptare kryesoi takimin e 21-të të Task Forcës Kundër Mashtrimit dhe Kontrabandës të SELEC (Qendra e Evropës Juglindore për Zbatimin e Ligjit) që u organizua më 12 nëntor në Bukuresht, Rumani, në përpjekje të vazhdueshme për të forcuar bashkëpunimin rajonal në fushën e tregtisë së paligjshme.

Qëllimi i takimit ishte sigurimi i një forumi në të cilin pjesëmarrësit mund të diskutojnë për qasjet rajonale në parandalimin dhe luftimin e mashtrimeve doganore dhe kontrabandës, duke synuar në përgjithësi forcimin e bashkëpunimit rajonal mes Doganës dhe Policisë në këtë fushë, si dhe vendosjen e drejtimeve të përbashkëta që duhen ndjekur në nivel rajonal.

Takimi u kryesua nga Z. Elton Kalemi, Oficeri Ndërlidhës i Doganës Shqiptare, si Koordinator i Task Forcës, i cili theksoi rëndësinë e zgjerimit të bashkëpunimit për ndikim më të suksesshëm në luftën kundër mashtrimit dhe kontrabandës në rajonin tonë.

DOGANAT BLOKOJNË 40911 COPË VESHJE "FAKE" DHE 10650 KG ÇAMCAKËZA "ORBIT" TË FALSIFIKUAR



Nga fillimi i vitit 2024, Administrata Doganore, si institucion ligjzbatues përsa i përket mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, ka pezulluar për çlirim në qarkullim të lirë 40911 copë veshje të ndryshme dhe aksesore, të cilat dyshohej se shkelnin pronësinë intelektuale të markave tregtare të Louis Vuitton, Moncler, Lacoste, Tommy Hilfiger, Chanel, Adidas, Prada, Emporio Armani, Calvin Klein, Miu Miu, Nokia etj., për të cilat ka një aplikim për veprim të miratuar pranë Autoritetit Doganor.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 ADSH ka pezulluar 10650 kg çamcakëza të importuar nga Kina, të markës tregtare "Orbit", të cilat u konfirmuan nga mbajtësi i së drejtës, se ishin të falsifikuara dhe mund të rezultojnë shumë të dëmshëm për shëndetin e konsumatorit shqiptar.

"ARMSTRONG IX", BLOKOHET NJË SASI PRODUKTESH FARMACEUTIKE TË PADEKLARUARA SIPAS PROCEDURAVE DOGANORE

Në kuadër të Planit Operacional Armstrong IX, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit zhvilluan një operacion me qëllim parandalimin dhe luftimin e trafikëve të paligjshme dhe kontrabandës. Si rezultat i këtij operacioni, nga kontrollet rigorozet të realizuara në postat e shpejta u bllokuan një sasi produktesh farmaceutike të cilat nuk ishin deklaruar sipas procedurave doganore.



Dogana Shqiptare mbetet e përkushtuar për të forcuar kontrollet kufitare, duke përdorur teknologji të avancuar dhe analiza të thelluara të riskut. Këto masa synojnë të sigurojnë tregtinë ndershme, të mbrojnë interesat ekonomike të vendit dhe të rrisin sigurinë për të gjithë qytetarët.

A E DINI SE?

Udhëtarët që vijnë nga një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë përjashtohen nga detyrimet e importit për mallrat që gjenden në bagazhin e tyre personal.

Mallrat përjashtohen nëse, për nga lloji dhe sasia e tyre, nuk kanë për qëllim përdorimin tregtar. Përfitojnë përjashtim mallrat e përdorimit vetjak të udhëtarëve ose mallrat për dhurata.

Vlera e mallrave që përfitojnë përjashtim (pa përfshirë këtu produktet e duhanit dhe alkolit) është sipas vlerës ekuivalente në lekë të shumave, si më poshtë:

Udhëtarët në rrugë tokësore: • 300 euro për çdo udhëtar

Udhëtarët në rrugë ajrore ose në rrugë detare: • 430 euro për çdo udhëtar

Për udhëtarët nën 15 vjeç: • 150 euro

Gjatë hyrjes ose daljes nga Republika e Shqipërisë, udhëtari duhet të deklarojë mallrat nëse janë me vlerë më të lartë se kufiri përkatës i sipërpërmendur si dhe nëse janë për qëllime tregtare.

Autoritetet doganore mund t'i kërkojnë udhëtarit që të tregojë të gjitha mallrat që transporton.

KUJDES!

Për mallrat me natyrë jo tregtare në bagazhin e udhëtarëve që e tejkalojnë kufirin e pataksueshëm nga detyrimet doganore të importit, kryhet deklarimi doganor nëpërmjet procedurës së Deklarimit të thjeshtuar.

DOGANA DIGJITALE

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës **E-Albania**.

Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit.

Vetëm gjatë muajit Nëntor 2024 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar 579 shërbime online.

